

FILLIMI > Kronikë

Të shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje të mbetur në tentativë, arrestohen dy vëllezërit shqiptarë në Spanjë

14 Mars, 2022 15:13



Madhësia e tekstit: - +

Dy vëllezër të shpallur në kërkim për vrasje në tentativë kanë rënë në pranga nga policia. Autoritetet bëjnë me dije se është arrestuar E. K., 37 vjeç dhe M. K., 41 vjeç, i cili përdorte një pasaportë të falsifikuar të Maqedonisë së Veriut.

Për të dy vëllezërit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Vrasje me dashje e kryer në bashkëpunim", e mbetur në tentativë dhe "Prodhim e mbajtje pa leje të armëve e municioneve luftarake".

Fast Albania

Vijon bashkëpunimi i ngushtë i strukturave të Policisë së Shtetit me homologët, për kapjen e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar.

Finalizohet operacioni policor ndërkombëtar i koduar "Valencia". Operacioni u realizua nga Fast Albania në bashkëpunim të ngushtë me Fast Spain dhe me Interpolin e të dy vendeve. Kapen dy vëllezër, të shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje të mbetur në tentativë.

Falë bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit në kohë, ndërmjet FAST Albania dhe FAST Spain për vendndodhjen e dy vëllezërve në kërkim, është organizuar dhe finalizuar operacioni policor ndërkombëtar i koduar "Valencia". Në kuadër të operacionit, në qytetin Valencia të Spanjës, bazuar në informacionet e dhëna nga Fast Albania, u bë e mundur kapja, nga Fast Spain, e dy vëllezërve të shpallur në kërkim ndërkombëtar, E. K., 37 vjeç dhe M. K., 41 vjeç, i cili përdorte një pasaportë të falsifikuar të Maqedonisë së Veriut. Për të dy vëllezërit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Vrasje me dashje e kryer në bashkëpunim", e mbetur në tentativë dhe "Prodhim e mbajtje pa leje të armëve e municioneve luftarake".

Ky operacion tregoi rëndësinë e krijimit të strukturës policore Fast Albania si dhe profesionalizmin dhe besueshmërinë e strukturave të Policisë së Shtetit për të vepruar si të barabartë me homologët.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: [spanjë](#)

TË NGJASHME



Ikën nga lufta, fëmijët ukrainas me kancer mbërrijnë në Spanjë për trajtim

13 Mars, 2022



Polonia arreston gazetarin spanjoll, ishte spiun i rusëve dhe planifikonte...


04 Mars, 2022



Njihuni me çiftin që flenë në dhoma të ndara, 40-vjeçarja tregon arsyen dhe pse ua rekomandon të gjithëve


Njihuni me çiftin që flenë në dhoma të ndara, 40-vjeçarja tregon arsyen dhe pse ua rekomandon të gjithëve

[balkanweb.com](#)



U largua nga "Për'puthen" pas përplasjeve me një konkurrente, kush është moderatori që pritet të zëvendësojë Arjan Konomin

[balkanweb.com](#)



Mbyllet votimi/ Nuk ka surpriza, zgjidhet presidenti i ri i FSHF-së

[balkanweb.com](#)

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA-KRONIKË



Ishte menaxher në kompaninë "Bana King" ku u zhblua kokaina që vinte nga Ekuadori, Apeli rikthehen sërish në burg Marson Murataj

15 Mars, 2022



Dy vëllezërit tentuan ta vrisnin, flet 45-vjeçari: Si më qitluan me tishat nga konflikti për makinën e shtit, tek sherr për vendin e parkimit të taksisë

15 Mars, 2022



"Rregorja" në aksion, arrestohen 20 drejtues automjeteash dhe pezullohen 117 leje drejtimi, policia jep detajet

15 Mars, 2022



Vithnin banesa dhe bizneset në Kamzë, 3 të rinj në pranga

15 Mars, 2022



Tentuan të vrisnin me thikë 45-vjeçarin në Tiranë, vihen në pranga dy vëllezërit (EMRAT)

15 Mars, 2022



Kanabla, armë dhe drejtim mjeti në gjendje të dhurë/ Arrestohen 4 persona në Tiranë për vepra të ndryshme penale

15 Mars, 2022

KATEGORIA VIDEO



"Alumni talk", niema e re e Universitetit "Luizgur" çdo javë bashkëbisedim me një ish-student, rikthen në autor Oriela Nebiain

15 Mars, 2022



A duhet bashkimi i PD kur Berisha njëj vetëm votim e liri, Tabaku flet për herë të parë pas 6 marsit: Kundërshtari ynë i vetëm është...

15 Mars, 2022



"Çnimi i energjisë për bizneset është rritur", Tabaku: Bori, shpikje allakomizim! Masat e qeverisë janë qesharake, duhet ndërhyrë në...

15 Mars, 2022



Sot vendoset nëse Rusia do përjashtohet nga Këshilli i Europës, Tabaku nga Strasburgu: PD do mbështesë rezolutën

15 Mars, 2022



Rritja e çmimeve/ Greqia merr masa, parlamenti pritët të miratohë paketën sociale prej 2 miliardë eurosh

15 Mars, 2022



"Kontratat për import-eksportin e mialit dhe misrit do vijojnë", Krifka në Beograd: Rikonfirmojmë marrëveshjen e 'Open Balkan' për tregtinë e lirë të mallrave

15 Mars, 2022